



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

U D H Ë Z I M

Nr.____, datë _____.2026

PËR MIRATIMIN E KODIT TË SJELLJES PËR LOBISTËT

Në mbështetje të shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr. 12/2026 “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

U D H Ë Z O N:

1. Miratimin e Kodit të Sjelljes për Lobistët, sipas tekstit bashkëlidhur këtij udhëzimi, i cili është pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen lobistët e regjistruar në Regjistrin e Lobimit, si dhe struktura përgjegjëse pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

KODI I SJELLJES PËR LOBISTËT

Neni 1 Objekti

Ky Kod përcakton parimet etike dhe rregullat e sjelljes që duhet të respektohen nga lobistët e regjistruar në Regjistrin e Lobimit, me qëllim garantimin e transparencës, integritetit, paanshmërisë, përgjegjshmërisë dhe besimit të publikut në procesin e vendimmarrjes publike.

Neni 2 Fusha e zbatimit

Ky Kod zbatohet për të gjithë lobistët e regjistruar në Regjistrin e Lobimit, sipas ligjit nr.12/2026 “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3 Parimet

Veprimtaria e lobimit ushtrohet në përputhje me këto parime:

- a) Ligjshmëria – lobisti vepron në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi dhe këtë Kod.
- b) Integriteti – lobisti ushtron veprimtarinë me ndershmëri, etikë profesionale dhe përgjegjshmëri, duke shmangur çdo veprim që cenon interesin publik ose besimin e publikut në procesin e vendimmarrjes publike.
- c) Transparenca –lobisti vepron në mënyrë të hapur dhe siguron që informacioni publik mbi veprimtarinë e lobistit të jetë i plotë dhe i vërtetë, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
- ç) Profesionalizmi – lobisti ushtron veprimtarinë me kompetencë, korrektësi, kujdes profesional dhe në përputhje me standardet etike.
- d) Mirëbesimi – lobisti vepron me ndershmëri dhe integritet në marrëdhëniet e tij dhe bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të shmangur çorientimin e zyrtarëve publikë, palëve të tjera të interesuara dhe publikut gjatë ushtrimit të veprimtarisë së lobimit.
- dh) Shmangia e konfliktit të interesit – lobisti identifikon, deklaron dhe shmang çdo konflikt interesi, me qëllim garantimin e paanshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së lobimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- e) Përgjegjshmëria – lobisti mban përgjegjësi për saktësinë e deklarimeve dhe informacionit që paraqet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së lobimit.
- ë) Respektimi i interesit publik – lobisti ushtron veprimtarinë duke respektuar interesin publik dhe duke vepruar në mënyrë që të mos cenojë besimin e publikut në procesin e vendimmarrjes publike.

Neni 4

Saktësia e informacionit

1. Lobisti paraqet pranë autoriteteve publike dhe Komisionerit vetëm informacion që, sipas dijenisë së tij dhe pas verifikimeve të arsyeshme, është i saktë, i plotë, i verifikueshëm dhe nuk përmban të dhëna të rreme.
2. Kur merr dijeni se informacioni i paraqitur prej tij është i pasaktë ose i paplotë, lobisti ndërmerr menjëherë masat e nevojshme për korrigjimin ose plotësimin e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Lobisti nuk përhap me vetëdije informacion të rremë me karakter diskreditues për autoritetin publik ndaj të cilit ushtrohet veprimtaria e lobimit.

Neni 5

Ndalimi i ndikimit të padrejtë

Lobisti nuk duhet të:

- a) ushtrojë presion ose ndikim të papërshtatshëm ndaj zyrtarëve publikë;
- b) përdorë kërcënime, shantazh ose forma të tjera të ndikimit të paligjshëm ose të papërshtatshëm;
- c) ofrojë ose premtojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, përfitime materiale ose jomateriale me qëllim ndikimin në procesin e vendimmarrjes publike;
- ç) përdorë ose të tentojë të përdorë informacione konfidenciale të siguruara në mënyrë të paligjshme ose në kundërshtim me detyrimet e konfidencialitetit;
- d) pretendojë ose të krijojë përshtypjen se gëzon ndikim të privilegjuar mbi zyrtarët publikë ose në procesin e vendimmarrjes publike;
- dh) përdorë tituj, simbole ose mënyra të tjera prezantimi që mund të krijojnë përshtypjen e gabuar se vepron në emër ose me autorizimin e një autoriteti publik.

Neni 6

Marrëdhëniet me zyrtarët publikë

1. Lobisti respekton pavarësinë, paanshmërinë dhe integritetin e zyrtarëve publikë.
2. Lobisti nuk kërkon dhe nuk nxit zyrtarin publik të veprojë në kundërshtim me ligjin, rregullat etike ose detyrat që rrjedhin nga funksioni i tij.
3. Lobisti respekton rregullat e komunikimit institucional dhe nuk përdor mjete ose praktika që cenojnë integritetin e procesit të vendimmarrjes publike.
4. Kur lobisti fton një zyrtar publik në një aktivitet që lidhet me veprimtarinë e lobimit, ai informon zyrtarin publik për personin ose subjektin që financon aktivitetin, përfshirë, sipas rastit, financimin nga palë të treta.
5. Përpara kontaktit me zyrtarin publik, lobisti kujdeset të njihet me rregullat ligjore dhe etike të disponueshme publikisht, që janë relevante për marrëdhënien me zyrtarin publik në kuadër të veprimtarisë së lobimit.

Neni 7
Bashkëpunimi me Komisionerin

Lobisti bashkëpunon me Komisionerin gjatë ushtrimit të kompetencave të tij dhe vepron me korrektësi, transparencë dhe mirëbesim në çdo procedurë administrative.

Neni 8
Konflikti i interesit

Lobisti identifikon, deklaron dhe shmang çdo konflikt interesi gjatë ushtrimit të veprimtarisë së lobimit, duke vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 9
Konfidencialiteti

1. Lobisti ruan konfidencialitetin e informacionit dhe dokumentacionit të siguruar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së lobimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe detyrimet kontraktore. Detyrimet kontraktore nuk mund të kufizojnë detyrimet për zbulimin, publikimin ose raportimin e informacionit, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
2. Lobisti merr masat e nevojshme për të siguruar që punonjësit dhe bashkëpunëtorët e tij të respektojnë detyrimet e konfidencialitetit që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së lobimit.

Neni 10
Marrëdhëniet me përfituesin e lobimit

1. Lobisti informon përfituesin e lobimit për:
 - a) të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për lobimin;
 - b) detyrimet që rrjedhin nga ky Kod;
 - c) çdo konflikt interesi që mund të ndikojë në përfaqësimin e interesave të tij.
2. Lobisti nuk garanton dhe nuk krijon pritshmëri për arritjen e një rezultati të caktuar në procesin e vendimmarrjes publike.
3. Lobisti informon përfituesin e lobimit për ecurinë e veprimtarisë së lobimit, si dhe për çdo rrethanë për të cilën merr dijeni dhe që mund të pengojë përmbushjen e kontratës së lobimit.

Neni 11
Ish-zyrtarët publikë

1. Lobisti që ka ushtruar më parë funksione publike respekton kufizimet dhe periodhat e papajftueshmërisë, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
2. Lobisti nuk përdor informacion jopublik, konfidencial ose të mbrojtur, të siguruar gjatë

ushtrimit të mëparshëm të funksioneve publike, dhe nuk shfrytëzon pozitën, lidhjet ose ndikimin e krijuar gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve për të siguruar përparësi të padrejtë në ushtrimin e veprimtarisë së lobimit.

3. Lobisti person juridik, kur angazhon për ushtrimin e veprimtarisë së lobimit një person që ka ushtruar më parë funksione publike, merr masat e arsyeshme për të verifikuar respektimin e kufizimeve dhe periudhave të papajtueshmërisë të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 12

Sjellja profesionale

1. Lobisti:
 - a) sillet me korrektësi, respekt dhe profesionalizëm në marrëdhëniet me Komisionerin, autoritetet publike, përfituesit e lobimit dhe personat e tjerë me të cilët bashkëvepron gjatë ushtrimit të veprimtarisë së lobimit;
 - b) komunikon me gjuhë profesionale dhe të respektueshme;
 - c) shpreh qëndrimet dhe mbron interesat që përfaqëson në mënyrë korrekte, objektive dhe me respekt ndaj autoriteteve publike dhe zyrtarëve publikë;
 - ç) nuk përdor simbolet, logot ose identitetin vizual të autoriteteve publike;
 - d) respekton veprimtarinë profesionale të lobistëve të tjerë dhe shmang çdo veprim që cenon në mënyrë të padrejtë reputacionin ose ushtrimin e ligjshëm të veprimtarisë së tyre.
2. Lobisti person juridik ndërmerr masa të brendshme, të arsyeshme dhe proporcionale, në varësi të natyrës dhe përmasave të veprimtarisë së tij, për të siguruar që personat që ushtrojnë veprimtari lobimi në emër të tij të njohin dhe të respektojnë detyrimet ligjore dhe etike që lidhen me veprimtarinë e lobimit dhe për të parandaluar rreziqet e sjelljeve të paligjshme ose joetike.
3. Lobisti promovon kulturën e transparencës, integritetit dhe respektimit të interesit publik gjatë ushtrimit të veprimtarisë së lobimit.

Neni 13

Ruajtja e reputacionit të profesionit

Lobisti ushtron veprimtarinë e lobimit në mënyrë që të ruajë dinjitetin dhe reputacionin e profesionit, si dhe të forcojë besimin e publikut në integritetin, transparencën dhe ligjshmërinë e procesit të vendimmarrjes publike.

Neni 14

Zhvillimi profesional

Lobisti kujdeset për përditësimin e vazhdueshëm të njohurive dhe kompetencave të tij profesionale në fushën e lobimit, standardeve etike dhe praktikave të mira që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së lobimit.

Neni 15
Mosrespektimi i Kodit

1. Mosrespektimi i dispozitave të këtij Kodi përbën shkelje të detyrimeve etike të lobistit.
2. Shkeljet e këtij Kodi shqyrtohen dhe trajtohen në përputhje me ligjin nr. 12/2026 “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe Kodin e Procedurave Administrative.
3. Zbatimi i masave administrative sipas legjislacionit për lobimin nuk përjashton përgjegjësinë administrative, civile ose penale, kur kjo parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

Neni 16
Dispozita përfundimtare

Me regjistrimin ose rinovimin e regjistrimit në Regjistrin e Lobimit, lobisti deklaron se njeh përmbajtjen e këtij Kodi dhe angazhohet për respektimin e parimeve dhe rregullave të sjelljes të përcaktuara në të.